

VENDIM
Nr. 7, datë 25.3.2026

PËR DHËNIEN E LICENCËS BANKËS “BANKA JET” SHA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 14, 20, 21 dhe 54, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; dhe të pikës 2 të shtojcës nr. 1 të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; si dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare bankës “Banka Jet” sh.a. në Republikën e Shqipërisë.
 2. Të miratojë kryerjen e veprimtarive bankare dhe financiare për “Bankën Jet” sh.a., sipas shtojcës 1 bashkëlidhur të këtij vendimi.
 3. Ngarkohet “Banka Jet” sh.a. që të njoftojë me shkrim Bankën e Shqipërisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për datën e fillimit të veprimtarisë.
 4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Operacioneve Monetare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 5. Ngarkohet Guvernatori me nënshkrimin e licencës të bankës “Banka Jet” sh.a. dhe aneksit të veprimtarive, bashkëlidhur licencës.
 6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko

Shtojca 1

Mbi veprimtaritë bankare dhe financiare, sipas përcaktimit të nenit 4 dhe nenit 54, pika 2, të ligjit për bankat, për të cilat licencohet dhe lejohet të ushtrojë veprimtari “Banka Jet” sh.a.:

- a) Pranimi i depozitave në para dhe i fondeve të ripagueshme nga publiku;*
- b) Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe hipotekare;*
- c) Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si: kartat e kreditit dhe të debitit, çeket e udhëtarit dhe çeket bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular) etj., përfshirë emetimin e parasë elektronike;*
- d) Shërbimet e pagesave duke përfshirë:*

i. Shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese;

ii. Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese;

iii. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:

- ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
- ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;

- ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.

iv. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:

- ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
- ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;

- ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.

v. Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave;

vi. Dërgesat e parave;

vii. Shërbimi i inicimit të pagesës;

viii. Shërbimi i informimit të llogarisë;

e) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:

i. Instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, certifikata të depozitave etj.);

ii. Këmbim valutor.